[Shqiptarja.com]

E martë 14 Mars 2023 - Përditësimi i fundit 22:12

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

CELIBASHI NUK REGJISTRON PD

POP 5 Lajmet me të lexuara të 5 minutave të fundit

Pikase prostin, ja sa ka shkuar në total çmimi, mësh i banorëve në Big Brother

Arrestohet për drejtësinë dëmtim i SENEA-s te "Kodra e Diellit" na Tiranë, iu gjetën mbi 100 mijë € në njërin e tij

Kryepolicë në mbyllë ndërsa masone flutuarne

Dorë amerikani u mësua nga ariani rus, SHBA- Pjesëtari lajlin paprofesionistët

VIDEO/ Dalin pamjet e shoqërisë qëi e mah nga policët gjatë Maria e Rj rënë ne dëgjo vëllain duke bërtitur 'O ma, mk shpëtoi se me vrasin

shqipëroi

Ngumbi jetën në aksidentin tragjik në Bisk, i punë lumturisë e fundit 19-vjeçares

Kronikë

Tregu i zi i armëve, si blihet pistoleta për 1 milionë lekë të vjetra në mes të Durrësit! Shitësi: E ke akull të re

Bisedat e para mes shitësit dhe bashkëpunëtores së Fiksit bëhen në një lokal, ku thuhet se pistoleta kushton 1 milionë e gjysmë lekë. Dhe vetëm 2 ditë më vonë bashkëpunëtorja e Fiksit bën pazare për të blerë një automatik tek i njëjti person, këtë herë kundrejt 1 milionë lekëve. Shitësi i prezantuar si Marin Prenga, i siguron bashkëpunëtorese se arma është në gjendje shumë të mirë, dhe se më parë ka shitur edhe dinamit, por tani ka frikë.

Foto ilustruese

Redaksia
14 Mars, 20:47 / **Përditësimi: 14 Mars, 20:53**

Emisioni Fiks Fare solli sonte një investigim mbi shitjen e armëve në treg të zi në vendin tonë. Fiks Fare tregoi me video e audio se sa e lehtë është të blesh të gjitha llojet e armëve pa patur asnjë leje nga policia për përdorimin dhe shitjen e tyre.

Gazetarët e Fiksit kanë mundur të bëjnë pazare për blerje pistoletash dhe automatikësh, madje kanë arritur dhe të blejnë automatik kallashnikov. Pazaret dhe blerjen bëhen në mes të ditës në një nga qytetet më të mëdha të vendit, siç është qyteti i Durrësit. Arma e njarrit bashkë me fishekë iu shit gazetarëve të Fiksit kundrejt 1 milionë lekëve të vjetra. Madje shitësi u premton se mund t'u sgurojë fare lehtë edhe pistoletë, në varësi të kërkesës.

LEXO EDHE:
Kundërshtoi me forcë punonjësin e Policisë Rrugore për gjobën e vënë, prangoset i riu në Kamëz

Bisedat e para mes shitësit dhe bashkëpunëtores së Fiksit bëhen në një lokal, ku thuhet se pistoleta kushton 1 milionë e gjysmë lekë. Dhe vetëm 2 ditë më vonë bashkëpunëtorja e Fiksit bën pazare për të blerë një automatik tek i njëjti person, këtë herë kundrejt 1 milionë lekëve. Shitësi i prezantuar si Marin Prenga, i siguron bashkëpunëtorese se arma është në gjendje shumë të mirë, dhe se më parë ka shitur edhe dinamit, por tani ka frikë.

Shitësi i armës e mori bashkëpunëtoren e Fiksit deri në vendin ku e mbante armën që ishte një hambarë bari. Aty edhe i tregon karikatorin me fishekë dhe e risiguron se arma është e regullt. Menjëherë gazetarët e Fiksit e dorëzuan armën në Komisariatin e Policisë Durrës kundrejt të gjitha procedurave ligjore. Dhe pas këtij momenti forcat operacionale të komisariatit në bashkëpunim me gazetarët e Fiksi lokalizuan dhe kapën shtetasin Maren Presku i prezantuar për bashkëpunëtorët e Fiksit me emër tjetër.

Takimi i parë me shitësin e armëve

> *Fiksi: Ju mirë kaloni?*
> *Shitësi: Mirë kalojmë, shtyjmë. Muhabetin ta kam thënë unë ty, kjo e don (pistoletën) për një mjek*
> *Fiksi: Infermier jo mjek*
> *Shitësi: Infermier*
> *Shoku i shitësit : Nuk më intereson më gjatë*
> *Fiksi: Ai e do për hall sepse në Kashar ka hapur një bleqtori, s'di si ta shpjegoj. Edhe i kanë vjedhur nja dy gjëra me thënë të drejtën.*
> *Shoku i shitësit: Është problem ajo punë nuk është siç ka qenë më përpara,*
> *Fiksi: Unë pranda i tha Marinit se e njoh,*
> *Shitësi: Kam pas shit shpesh kapsolla dinamiti,*
> *Fiksi: Ku e gjeje dinamitin ti?*
> *Shitësi: Tash nuk ka ma, nuk du me ra në burg, nuk kam më moshë. Pashah kryt e kalamajve me nejt 40 vjet shok edhe gru edhe dashnore me mua, unë me të besu nuk të besoj njëherë, erdhi koha.*
>
> *Fiksi: Sa 7 Më thuaj çmimet dhe të vijë tjetri të bëjë muhabet me ty,*
> *Shitësi: Do bëhet sa më shpejt por edhe ashtu shpejt nuk bëhen gjërat, tani ka probleme për atë sen (pistoletë) ajo.*
> *Fiksi: Tani sa shkon që të përgatitet?*
> *Shitësi: Kané shku shtrenjtë, janë tu shku shtrenjtë, shkon e gjysmë ajo (1 milion e gjysëm lekë)*
> *Fiksi: 1 e gjysmë, po mirë shumë mirë, që t'ja them. Do t'i them unë atij të vijë të bësh muhabet vetë.*
> *Shitësi: Jo, s'dua hic, s'dua hiç fare që të vijë të bëjë muhabet. Kur të vijë me marrë mallin, vjen shef mallin merr mallin, i pëlqen nuk i pëlqen.*

Takimi ku blihet dhe arma automatik, kallashnikov

> *Fiksi: Marin, lekët i kam unë. Al është rreth 1 km aty te rrethrotullimi ku është ajo, ai marketi .*
> *Shitësi: Po unë ta fus këtu, në makinë këtu tak*
> *Fiksi: Po mirë, po hajde tani se nuk bëhenj muhabetet në këmbë.*
> *Shitësi: Hajde shkojmë e futna atje*
> *Fiksi: Hajde hip në makinë. Muhabeti është që të mos fëlliqem edhe unë, është e saktë ajo?*
> *Shitësi: Për kyr e kalamajve ee*
> *Fiksi: Se vjen më merr mua...*
> *Shitësi: Jam 55 vjeç burrë unë, për kry të fëmijëve akull e re. Këtu këtu, kësaj rrugice këtu në krahë të majtë. Kaloi këtu makina. Ore unë kam një fjalë nuk e lëvizi,*
> *Fiksi: Po ku të vij unë tani? Do vijmë në këmbë ne ?*
>
> *Shitësi: Ja moj këtu te barakja, këtu brenda te bari.*
> *Fiksi: Do vij unë pas teje, të siguroi makinën 1 minutë.*
> *Shitësi: Me mua je.*
> *Fiksi: O Marin*
> *Shitësi: Hajde këtu.*
> *Fiksi: Hape njëherë ore. Është er pastër?*
> *Shitësi: Oo, oo, po po rri pa fjie maraku, tash ti ke me më thënë Marin, shumë faleminderit prej teje.*
> *Fiksi: Tani a ka ndonjë gjë që vihet këtu brenda? Ça është ajo?*
> *Shitësi: Mbaje këtë (karikatoren) . Ja ku është dhe karikatorja*
> *Fiksi: Paska dhe fishekë ë?*
> *Shitësi: Plot me fishekë.*
> *Fiksi: Nuk e provon dot?*
> *Shitësi: Ee ku je në '97-ën ti? Shko e provoje natën atje. Ti ke me më marrë prapë në telefon sonte, Marin çdo gjë në rregull*
> *DFiksi: Po se ai do ta provojë atje ku të gjenjë hapësirë*
> *Shitësi: Po, po*
> *Fiksi: Atëherë këtu janë 1 milionë*
> *Shitësi: Shumë bukur*
> *Fiksi: Prit ti numëroi 1,2,3,4,5,6,7, 8,9,10 . 1 2 3 4 5 6 7 8 9 20 20 herë 5 bëjnë 1 milionë.*
> *Shitësi: Bukur, po*
> *Fiksi: Hajt ma sill ti deri te makina. I ka (fishekët), sa kishim këtu brenda?*
> *Shitësi: 30.*
> *Fiksi 30./**TCH***

A.M./Shqiptarja.com

TAG: Dumes Marin Prenga tregu i zi kallashnikov ARMA

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Celibashi nuk regjistron Partinë Demokratike për 14 Majin, si e vlerësoni?

E gabuar | E drejtë | Nuk e di

Lajme të tjera

Denoncon komshiun dhunues, prej 1 vit e gjysmë sorollatet mes policisë e prokurorisë
13 Mars, 22:16

Mësim me turne në shkollën '14 nëntori' në Durrës, u dëmtua nga tërmeti! Nxënësit kërkojnë rikonstruksionin
Aldo Mustafa
13 Mars, 20:51

Tentuan të kalonin kufirin me dokumente të falsifikuara, arrestohen 3 persona në Portin e Durrësit
13 Mars, 15:35

E trishtë/ Ndahet nga jeta në moshën 70-vjeçare burmesha e Durrësit
13 Mars, 10:39

Atentati mafioz në Tiranë, gjendet një 'Passat' e djegur me dy kallashnikovë në Bubq të Fushë-Krujës! Dyshohet të jetë e autorëve
13 Mars, 09:09

'Vendoret', Meta nis fushatën në Durrës: Fondet e qytetit janë vjedhur, na votoni që ta kthejmë vendin si në 2005-n
12 Mars, 17:47

U kap me 324 kg kokainë në Portin e Durrësit, shoferi i kamionit dënohet me 12 vite burg! Përfiton gjykim të shkurtuar, do vuajë vetëm 8 vite
12 Mars, 15:36

Probleme me furnizimin me ujë gjatë dy ditëve të ardhshme për banorët e Durrësit! Shkak defekti teknik i tubacionit kryesor
10 Mars, 22:42

Moti i keq përfshin Durrësin, pezullohet lundrimi për anijet e peshkimit
10 Mars, 16:35

Përgjaken rrugët e vendit/ 3 aksidente me pasojë vdekjen në Durrës, Kavajë dhe Korçë! Përplasen 2 këmbësorë, shoferja 30 vjeçe përfundon në kanal
10 Mars, 12:28

Moti i keq në vend, pezullohet lundrimi i mjeteve të vogla në Vlorë dhe Durrës! Reshjet e shiut shkaktojnë përmbytje në lagjet e Lezhës, bllokohen 4 familje
10 Mars, 11:55



Sekuestrohen në portin e Durrësit 150 mijë euro dhe 164 mijë paund! Ishin fshehur në kabinën e kamionit, arrestohet shoferi (EMRI)
9 Mars, 11:50

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gjithë bisedat

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje